



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 43/2024

Datë: 15 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1.12 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe në bazë të nenit 29 paragrafi 6 të Rregullores Nr.05/2020 për Vlerësimin e Performances së Prokuroreve, në takimin e mbajtur me datë 15 janar 2024, mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet kundërshtimi i paraqitur nga prokurori i Shtetit, z. Qazim Xharra, ndaj Raportit përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokuroreve, KVPP-387/2023 i datës 08 dhjetor 2023.
- II. Obligohet Komisioni për Vlerësim të Performancës së Prokuroreve që të bëjë rivlerësimin e prokurorit Qazim Xharra.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 15 janar 2024 ka shqyrtuar Raportin përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokuroreve, KVPP-357/2023 i datës 8 dhjetor 2023 si dhe kundërshtimin e paraqitur nga prokurori, z. Qazim Xharra kundër raportit të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorit, KVPP-574/2023.

Pas shqyrtimit të Raportit dhe Kundërshtimit, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Qazim Xharra;
- Z. Ardian Hajdaraj, Kryetar i KVPP;
- Arkivit të KPK-së.